

NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PUNE

Në zbatim të Ligjit Nr. 10164 datë 15/10/2009, “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.757, datë 13/12/2024”Për disa ndryshime në Vendimin Nr.276, datë 16/05/2018, të Këshillit të Ministrave ‘Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar’”, të ndryshuar, Rregullores së Brendshme Nr.7493/2, datë 04/09/2018, miratuar me Vendim Bordi Nr.10, datë 04/09/2018,të ndryshuar, konkretisht neni 16 “Kërkesa të përgjithshme për të qenë punonjës i ARRSH” dhe neni 17 “Kërkesa specifike dhe procedura e pranimit në punë si punonjës i Autoritetit”, Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, neni 14 “Kriteret e pranimit për nivelet në shërbimin e MZSH-së” dhe VKM-së Nr.520, datë 25.07.2019, “Për miratimin e Rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”:

A:Numri i vendeve vakante në pozicionet:

SEKTORI I MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPETIMI TUNELI KRRABA

		15vende
PËRGJEGJËS SEKTORI	Nivel i mesem	1
INSPEKTOR	Nivel i mesem	1
KRYEZJARRFIKES	Nivel baze	1
ZJARRFIKES	Nivel baze	7
SHOFER ZJARRFIKES (Asistent zjarfikes)	Nivel baze	4
ZJARRFIKES (Zevendesues lejesh)	Nivel baze	1

SEKTORI I MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPETIMI TUNELI LLOGARAJA

		15vende
PËRGJEGJËS SEKTORI	Nivel i mesem	1
INSPEKTOR	Nivel i mesem	1
KRYEZJARRFIKES	Nivel baze	1
ZJARRFIKES	Nivel baze	7
SHOFER ZJARRFIKES (Asistent zjarfikes)	Nivel baze	4
ZJARRFIKES (Zevendesues lejesh)	Nivel baze	1

SEKTORI I MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPETIMI TUNELI SKERFICA

		15vende
PËRGJEGJËS SEKTORI	Nivel i mesem	1
INSPEKTOR	Nivel i mesem	1
KRYEZJARRFIKES	Nivel baze	1
ZJARRFIKES	Nivel baze	7
SHOFER ZJARRFIKES (Asistent zjarfikes)	Nivel baze	4
ZJARRFIKES (Zevendesues lejesh)	Nivel baze	1

B: Kriteret e pranimit për nivelet në shërbimin e MZSH-se

Shërbimi i Sektorëve të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi janë struktura të specializuara të gatishmërisë së përhershme, misioni i të cilave është inspektimi, parandalimi me masat e



mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja për shurjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjëse së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidenteve të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkatuara nga dora e njeriut.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për punësim si personel në sektoret e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi tek tynelet pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar janë:

1. Për nivelin bazë të këtij shërbimi kriteret janë:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar;
- ç) të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, Policia e Shtetit apo nga institucionet e tjera të administratës publike;
- d) të ketë mbaruar arsimin e mesëm;
- dh) të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- e) të jetë i/e moshës nën 30 vjeç;
- ë) të ketë përfunduar testimin fiziko-profesional dhe kursin përkatës pranë Akademisë së Sigurisë ose në qendra të trajnimit zjarrfikës.

2. Për nivelin e mesëm kriteret janë:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë përfunduar arsimin e lartë policor, ushtarak, juridik ose inxhinieri, niveli minimal i diplomës “Bachelor”;
- c) të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar;
- ç) të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, i Policisë së Shtetit apo nga institucione të tjera të administratës publike;
- d) të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale me dashje.



D: Dokumentat për dorëzim

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Shërbime të Brendshme të Autoritetit Rrugor Shqiptar Tiranë këto dokumente:

1. Curriculum Vitae (në formatin Europass)
2. Diplomë universitare dhe/ose masteri e noterizuar
3. Listë notash e noterizuar
4. Librezën e punës (nëse ka)
5. Librezën e sigurimit shoqëror e shëndetësor (nëse ka)
6. Vërtetim shëndetësor nga Komisioni Mjeko-Ligjor
7. Fotokopje ID
8. Adresën e vendbanimit ose ndonjë dokument tjetër të nevojshëm sipas specifikës së vendit të punës.
9. Dëshmi penaliteti
10. Dëshmi të ndryshme kualifikimi.

*Mungesa e një prej dokumentacioneve të kërkuara më sipër, sjell s'kualifikim të kandidatit.

Dokumentacioni i dorëzuar nuk do të kthehet mbrapsht, pasi bëhet pjesë e arkivës së Institucionit.

Kandidatët e interesuar, duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në Sektorin e Arkivë-Protokollit, në Autoritetin Rrugor Shqiptar (Adresa: Rruga e Sami Frashëri, Nr.33 Tiranë)

Afati i dorëzimit të dokumentacionit: **06/05/2025 – 15/05/2025 (10 ditë).**

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrimit me dosje dhe me intervista të drejtpërdrejta. Për çdo paqartësi mund të dërgohet email në adresën info@arrsh.gov.al

E: Mënyra e vlerësimit:

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Në lidhje me intervistën e punës kandidatët do të vlerësohen për njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës; Eksperiencën e tyre të mëparshme; motivimin, aspiratat dhe pritshmërinë e tyre për karrierën.

